

PREZANTIM HYRËS I KATËR PROJEKTEVE TË PERIUdhËS PAS TËRMETIT

Pas katastrofave ne shkallë të gjerë të tilla si tërmeti që goditi Shqipërinë në Nëntor 2019, zakonisht bëhet një vlerësim i shpejtë i ndarë sipas sektorëve. Qëllimi kryesor i këtij vlerësimi është të evidentojë nevojat e popullsisë për ushqim, ujë dhe strehim. Ky vlerësim merr në konsideratë edhe dëmet e shkaktuara në infrastrukturën vitale të vendit si infrastrukturë, komunikacion, rrjete elektrike etj... Menjëherë pasi kalohet faza imediate e sigurimit të ujit ushqimit dhe strehës kalohet tek faza tjetër e vlerësimit të nevojave pas katastrofës (PDNA). Këtu merren në konsideratë të gjithë sektorët, përfshirë edhe kulturën dhe qëllimi është që të japet një vlerësim i dëmeve, humbjeve dhe risqeve në vazhdimësi.

Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në trashëgimi kulturore mbas katastrofës është një pjese përbërëse e vlerësimit të nevojave pas katastrofës (PDNA) e cila duhet të ndihmojë për të përcaktuar dëmet e rikuperimit të trashëgimisë materiale dhe asaj jo-materiale.

Një nga veshtirësitë kryesore për të kryer një vlerësim të shpejtë të dëmeve në trashëgimi kulturore është mungesa e të dhënave bazë dhe sistemeve të monitorimit dhe analizimit. Grupet e ngritura nga IKTK për vlerësimi e dëmeve evidentuan rreth 49 objekte të trashëgimisë të klasifikuara në gradën e III'të (dëme të moderuara) të dëmtimit sipas EMS-98 dhe, katër të klasifikuar sipas gradës të IV'të (shumë të rënda) dhe V'të (shembje) po sipas EMS-98.

Kulla C e fortifikimeve në Durrës, Teqeja e Dollmës dhe Kulla e Sahatit në Kalanë e Krujës dhe Kulla dhe muret e fortifikimit të Kalasë së Prezës - ishin katër nga 53 monumentet e dëmtuara sipas gradës IV dhe V në tërmetin e nëntorit 2019.

Që prej muajit Dhjetor 2019 Trashëgimia Kulturore pa Kufij-Shqipëri (CHWB-A) me mbështetjen financiare të Fondit të Ambasadorit për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore (AFCP) dhe Ambasadës Amerikane në Tiranë është duke punuar për rikuperimin e dëmeve në katër objektet e dëmtuara rëndë dhe rikthimin e tyre në gjendjen e mëparshme. Përgjatë 15 muajve të kaluar nga dita e tërmetit deri sot ekipi i CHWB-A është angazhuar në dokumentimin, analizimin dhe hartimin e projektit të ndërhyrjeve stabilizuese, konservuese dhe përforcuese si dhe implementimin e tyre. Shkaqet e dëmeve në këto struktura kanë qenë si pasojë e lëkundjeve sizmike të kombinuara me karakteristikat e tipologjisë, problemeve strukturore apo ndërhyrjeve të gabuara në kohë siç, shpjegohet në paragrafët vijues. Hartimi i ndërhyrjeve në këto objekte është kryer sipas rekomandimeve të kartave të konservimit, udhëzimeve të English Heritage për riparimin e ndërtesave historike dhe udhëzimeve të ISCARH për përforcimin dhe rritjen e kapacitetit sizmik të ndërtesave historike.

KULLA C NË KALANË E DURRËSIT

Kulla C është një nga monumentet më të rëndësishme të arkitekturës ushtrake, e ndërtuar në shekullin e 5'të pas.k nga perandori Bizantin Anastasi I, si pjesë e murreve rrethuese të qytetit të Durrësit. Përgjatë shekujve ky monumet ka kaluar në disa faza historike ku më evidentet janë ato të periudhës Anzhuine dhe Otomane. Tërmeti i Nëntorit 2019 rrëzoi pjesërisht murin Bizantin të ndërtuar me tulla qeramike dhe veshjen Otomane të ndërtuar me mur guri të çrregullt. Në Maj 2020 u krye ndërhyrja emergjente për stabilizimin e strukturës për ti dhënë kohë procesit të kryerjes të analizave gjeologjike, vëzhgimit të terrenit me GPR, sondazheve arkeologjike, analiza të përbërjes të materialeve si dhe studim multidisiplinor të sjelljes sizmike, për të kuptuar shkaqet e shembjes dhe, lehtësuar procesin e hartimit të projektit. Hartimi i projekti u përmbyll në muajin Dhjetor 2020 dhe disa nga punimet parashikojnë: konsolidim themeli, ringritjen e blloqeve të rrëzuara, riparim të mureve si dhe vendosjen e elementëve përforcues me tiranta inoksi për përmirësimin e kapacitetit sizmik të strukturës. Punime restauruese filluan në Marsi dhe do të zgjasin 10 muaj.



Figura. 1 Kulla C në Kalanë e Durrësit pas tërmetit të Nëntorit 2019

TEQJA E DOLLMES NË KALANË E KRUJËS

Teqeja E Dollmës është një tjetër monument i rëndësishëm i arkitekturës të kultit ndërtuar sipas formes plan katror me kube. Tek ky monument dallohen dy faza historike ajo filestare për të cilën nuk dihet data e ndërtimit dhe, ajo dytë që ka të bëjë me rindrtimin e kupolës, që sipas Markel Kiel daton në shekullin e 18'të rreth vitit 1780-1790. Si pasojë e tërmetit u përkeqësuan akoma më shumë dëmtimet ekzistuese të cilat rezultojnë në çarje në strukturë deri në 5-6 cm. Zhvillimi i projekti u fokusua në dy drejtime; konservimi i pikturës murale dhe, analizimi strukturor dhe hartimi i ndërhyrjeve restauruese dhe përforcuese. Analizimi i sjelljes sizmike u krye nëpërmjet evidentimit të mekanizmave lokalë sipas manualit Italian të vlerësimit të objekteve të trashëgimisë dhe llogaritjen e tyre me metodën kinematike. Gjithashtu, për llogaritjen e kapacitetit sizmik u përdor edhe metoda numerike. Hartimi i projektit u përmbyll në muajin Nëntor 2020 dhe disa nga punimet parashikojnë: konservim i pikturës murale, përforcim i strukturës të mureve dhe themeleve, përforcim i kupolës dhe vendosje e tirantave prej inoksi për përmirsimin e sjelljes sizmike në rast tërmeti. Punimet restauruese filluan në fillim të marsit dhe parshikohet të zgjatin 12 muaj.



Figura. 2 Teqeja e Dollmës pas tërmetit të Nëntorit 2019



Figura. 3 Interior I Teqësë të Dollmës pas tërmetit të Nëntorit 2019

KULLA E SAHATIT NË KALANË E KRUJËS

Kulla e Sahatit në Kalanë e Krujës është një nga ndërtesat më ikonike në trashëgiminë ndërtimore në Shqipëri. Ajo daton që në shekullin e 12'të dhe është e ndërtuar sipas formës plan katror. Edhe tek ky monument dallohen disa faza historike ku ajo më e fundit është e vitit 1980 kur ju rrit lartësia me 1 m pas dëmeve të tërmetit të vitit 1979. Si pasojë e lëvizjes të shkëmbit u vendos që fillimisht të kryhen ndërhyrje emergjente stabilizuese në mënyrë që ti hapet rruga implementimit të ndërhyrjeve përforcuese në shkëmbin e kalasë. Punimet prashikojnë vendosjen e elementëve veritkalë prej çeliku dhe tirantimin e tyre me kavo inoksi duke e berë strukturën e kullës të aftë për të përballuar një nivel dridhjes prej 0.05g, të cilat mund të shkaktohen gjatë përpërforcimin të shkëmbit. Këto punime filluan në muajin Mars dhe do të zgjasin 6 javë.



Figura. 4 Kulla e Sahatit pas pas tërmetit të Nëntorit 2019

KALAJA E PREZES, KULLA E SAHATIT

Kajala e Prezës mendohet që të jetë ndërtur në shekulin e 3'të pas.k por, dokumentat me të hershme që flasin për të janë prej shek 15'të nga periudha e Topiajve. Ashtu si gjithë monumentet edhe ky monument ka kaluar ne disa faza të ndryshme historike lehtësisht të dallueshme. Si pasojë e tërmetit u shembën pjesërisht Kulla Rrethore në krahun verior dhe Kulla e Sahatit në krahun perëndimor. Analizimi i sjelljes sizmike u fokusua tek evidentimi i mekanizmave lokale sipas manualit Italian te vlerësimit të ndërtesave të trashëgimisë kulturore, përcaktimin e kapacitetit sizmik dhe hartimin e ndërhyrjeve për rritjen e aftësisë për të përballuar lëkundjet sizmike në të ardhmen. Hartimi i projektit përfundoi në muajin Dhjetor 2020 dhe disa nga punimet parashikojnë: restaurimin e të dyja kullave, trajtimin e murreve rrethuese, rindërtimin e shkalleve prej druri në kullën e Sahatit si dhe vendosjen e tirantave prej inoksi me qëllim rritjen e kapacitetit sizmik. Punimet restauruese filluan në fund të muajit mars dhe, kohëzgjatja e tyre është 6 muaj nga dita e fillimit të punimeve. Këto punime pritet të përfundojnë në muajin Gusht.



(a)



(b)

Figura. 5 Kalaja e Prezës pas pas tërmetit të Nëntorit 2019 (a) kulla e sahatit, (b) kulla rrethore ne krahun verior